



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE  
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE  
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Shoqata Radio Maria (OJQ)  
Nr. i regjistrimit: 5102515-6  
Greta KAÇINARI  
Drejtoreshë  
Radio Maria  
Rr/Brigada 123, p.n.  
Therandë

Ref: 1707/669/LIC/ni

**VENDIM**

*për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio Maria, me seli në Therandë*

**Fakte**

1. Komisioni i Pavarur për Media (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuale, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. Radio M është Ofrues i Shërbimeve Mediale Audio me mbulim Regjional, i cili është i licencuar për të transmetuar radio programe në shërbim të qytetarëve të Komunës e Therandës.
3. Më 11 korrik 2017, Radio Maria ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendndodhjes së lokacionit të sistemit të transmetimit në pikën e transmetimi në Zym për ku janë të licencuar për të transmetuar, për të vendosur transmtuesin në objektin ku janë të vendosura antenat të kompanis IPKO i cili gjendet poashtu në Zym, në një distancë prej 50 m.
4. Arsytimi i pronarit të Radio Maria, për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit, mbështetet në mungesë të energjisë elektike dhe problemeve me internetin.
5. Më datë 31 mars 2017, Departamenti i Menaxhimit Frekuencor (DMF) i KPM-së ka realizuar matjet teknike në pikën e propozuar për vendosjen e transmetuesit të Radio Maria në lokacionin Zym, me lartësi mbidetare 662 m, për të vlerësuar gjendjen

faktike në terren si dhe ka bërë analizën e rezultateve lidhur me ndryshimin e lokacionit të transmetimit, sipas kërkesës së Radio Maria.

### Arsyetim

6. Neni 16 i Kushteve dhe termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 1 thekson se: *Përveç dispozitave për bartjen e pronësisë të specifikuar në Nenin 15, i Licencuari paraprakisht parashtron kërkesë me shkrim për ndryshimet e specifikuara në paragrafet e Pjesës 2 të Licencës së KPM-së si dhe në Pjesët 3 dhe 4, përfshirë frekuencën, Fuqinë e Rrezatuar Efektive dhe vendndodhjen e transmetuesit ose antenës, formatin e programit dhe zonën e mbulimit. Ndryshime të tilla mund të bëhen vetëm pasi të jenë miratuar nga ana e KPM-së.*
7. Gjithashtu, neni 16 i Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës së KPM-së, paragrafi 2 thekson se: *“Me anë të dërgimit të një njoftimi me shkrim të të Licencuarit, KPM-ja mund të ndryshojë kushtet e Pjesës 2, Standardet Teknike, Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës së transmetimit me një procedurë të përcaktuar në pajtueshmëri me Ligjin e KPM-së. KPM-ja do të sigurohet që këto ndryshime janë të domosdoshme për të garantuar një përdorim më të rregullt të spektrit frekuencor”.*
8. Në bazë të vlerësimit të rezultateve të DMF-së, Komisioni konstaton se, ndryshimi i lokacionit të transmetimit sipas kërkesës së Radio Maria, është i pranueshëm për arsye se dallimet në mes të pikës së tanishme (me lartësi mbidetare prej 664 m) dhe asajë të propozuar për vendosjen e trasmetuesit (me lartësi mbidetare prej 662 m) janë të vogla dhe nuk do të ketë ndryshime të theksueshme në zonën e mbulimit.
1. Në pajtim me nenin 16, paragrafi 1 të Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, Komisioni konstaton se, kërkesa për ndryshimin e lokacionit të sistemit të transmetimit të Radio K është e bazuar dhe në pajtueshmëri me Kushtet dhe Ternet e Licencës KPM-së, dhe si e tillë i plotëson kushtet për miratim.

### Vendim

9. Ne takimin e mbajtur me datën 1 gusht 2017, Komisioni merrë vendim për ndryshimin e lokacionit të transmetuesit, sipas kërkesës së Radio Maria, në pikën e transmetimit në Zym, për ku janë të licencuar për të transmetuar sipas licencës, dhe kalimin në objektin e kompanis IPKO, poashtu i vendosur në pikën e transmetimit në Zym.

### Lëshimi i Vendimit

10. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.

Adnan MEROVCI

Kryetar

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



02.08.2017

datë